

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Afrim Shala anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Jeton Leci, në çështjen penale kundër të akuzuarve K.R. dhe B.M., që të dy nga fshati ..., për shkak te veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1, nën par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit K.R., av. F.A. të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.966/2018 të datës 12.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.12.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit K.R., av. F.A., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.966/2018 të datës 12.11.2018, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.966/2018 të datës 12.11.2018, të akuzuarit K.R. dhe B.M. i ka shpallur fajtorë për shkak te veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1, nën par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, që të dy i ka gjykuar me dënim me burgim me kohëzgjatje prej nga 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej nga 1500 ( një mijë e pesëqind) €, secilit prej të akuzuarve, ashtu që dënimi do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë në bazë të nenit 47 të KPP-së dhe me pëlqim të akuzuarve dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, ia ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dy mijë) €, secilit veç e veç, nëse të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë, dënimi me gjobë revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me 6 (gjashtë) muaj burg, në bazë të nenit 83 të KPP-së të akuzuarve në dënimet e shqiptuara me burgim do iu llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.13.10.2018 deri më 01.11.2018. Të akuzuarit janë obliguar të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 30 (tridhjetë) €, secili veç e veç, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari I.G. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të akuzuarit K.R., av. F.A. dhe atë vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit K.R. ti shqiptojë dënim më të ulët me gjobë.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.1276/2018 datë 17.12.2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit K.R., av. F.A. të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**- Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarve.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimin të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, me ankesë mbrojtësi i të të akuzuarit K.R., av. F.A. pretendon se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit nuk i ka vlerësuar në mënyrë të duhur rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit të parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, si dhe nenin 75 dhe 76 të KPRK-së, lidhur me mundësin e zbutjes së dënimit. Pra, sipas ankesë së mbrojtësit, dënimi i shqiptuar nuk është adekuat dhe në proporcion me përgjegjësinë penale të të akuzuarit. Mbrojtësi në ankesë potencon se duke e marrë parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, se është i moshës së re, sjelljen e tij korrekte në gjykatë, pendimin për kryerjen e veprës penale, gjendjen e varfër pasurore të tij, baba i dy fëmijëve të vegjël, i shkurorëzuar, konsideron se ka vend që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i ulët me gjobë.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit K.R., av. F.A. për shqiptimin e një dënimi më të ulët me gjobë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 dhe 76 të KPK-së, me ç' rast si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e shkallës së parë e ka zbutur dënimin ndaj të akuzuarve dhe ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se të dy të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në shqiptimin fillestarë të dt. 01.11.2018, e si rrethana tjera posaçërisht lehtësuese gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe faktin se të akuzuarit kanë bashkëpunuar me prokurorinë e shtetit, se pranimin e fajësisë e kanë bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se të akuzuarit janë penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë penale, se të njëjtit i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale, si dhe kanë treguar sjellje korrekte gjatë gjyqimit ndërsa gjykata e shkallës së parë si rrethanë rënduese ka vlerësuar shkaktimit e dëmit material të tani të dëmtuarit I.G..

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit K.R. që të akuzuarit K. ti shqiptohet një dënim më i ultë me gjobë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, ngase duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e me qenë se në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit K.R., nuk theksohet ndonjë rrethanë e re lehtësuese, e që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe që do të ndikonte në shqiptimin e ndonjë dënimi tjetër, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjyqimit të ankimit, ndaj të akuzuarit K. është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutorë dhe se ky dënim do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tyre, dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjyqimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1273/18 me datë 19.12.2018**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Jeton Leci**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**  
**Gani Zabeli**

**Anëtarët e kolegjit:**

**Shqipe Qerimi**  
**Afrim Shala**